



Zyra e Kryetarit të Komunës

Nr. 02/Zyrtarisht

Datë: 15 korrik 2026

Bazuar në nenin 42, paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 12, paragrafi 5, pika 5.3, paragrafi 8, të Rregullores (QRK) Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, Komuna e Deçanit me datë: 15.07.2026, shpall këtë:

## **SHPALLJE PUBLIKE**

(Për profesor të fushës-zëvendësues)

**Titulli i vendit të punës:** Profesor i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi, organizata të specializuara apo universitetet.

**Vendi i Punës:** Komuna e Deçanit

Pagesa fikse është 250 euro e cila paguhet për secilën procedurë të rekrutimit kategoria funksionale Specialist/e.

**Mandati i ekspertit është:** dy (2) vjeçar.

**Detyra e ekspertit është:** Vlerësimi profesional i kandidatëve për pranim Nëpunësja/i i shërbimit civil, për kategorinë e specialistes/it.

### **Kriteret dhe dokumentet që duhet bashkëngjitur me aplikacion:**

- Diplomë universitare me të paktën 240 kredi -për edukimin e marr jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës;
- Të ketë përvojë pune të paktën katër (4) vite në Universitet apo organizata të specializuara;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos jetë i punësuar në Shërbimin Civil, të mos jetë i larguar nga Shërbimi Civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshmi që nuk është i dënuar penalisht për kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Deklaratë se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Deklaratë se nuk është i punësuar në Shërbimin Civil, të mos jetë i larguar nga Shërbimi Civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Formulari i aplikimit merret në Zyrën Pritëse kati përdhese dhe dorëzohet në Zyrën Pritëse, nga ora: 08:00<sup>h</sup>-16:00<sup>h</sup> në objektin e komunës së Deçanit, formularët mund të merren edhe në linkun e ueb faqes komunale: <https://konkursi.rks-gov.net/> .

*Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 8 (tetë) ditë nga data: 16/07/2026 deri 23/07/2026.*

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret hyjnë në listën e ngushtë dhe njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike dhe telefonit.

|                                                                                     |             |                                                                                        |          |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------------------------------------------------------------------------------------|----------|
|  |             | REPUBLIKA E KOSOVES<br>KOMUNA E DECANIT<br>REPUBLIC OF KOSOVA<br>MUNICIPALITY OF DEÇAN |          |
| N. i aplikimit                                                                      | Z. Kryetari | N. i aplikimit                                                                         | 14014    |
| N. i aplikimit                                                                      | 02          | N. i aplikimit                                                                         | 15-07-26 |
| DEÇAN, DEÇANE                                                                       |             |                                                                                        |          |

Kryetari i komunës:  
  
Bashkim RAMOSAJ

